

QYTETARËT E DEMOKRACISË



NË VEPRIM

DEMOKRACIA DHE RËNDËSIA E SAJ

FAZILE (14), FLAKA (14), RONA (14), ALBIONA (14), LEONITA (14), ALBIONA (14), ELZA (14),

ABETARE (14)



Për të kuptuar funksionimin e demokracisë dhe rëndësinë e saj, mos e humbisni rastin ta lexoni artikullin e përgatitur nga ne

Demokracia është shumë e rëndësishme për një qeverisje sa më të mirë të shtetit. Me zhvillimin e demokracisë, të gjithë ne qytetarët kemi të drejtën e fjalës dhe shumë të drejta të tjera.

Fjala demokraci rrjedh nga fjala „demos“ që do të thotë popull dhe „kratos“ që do të thotë qeverisje apo udhëheqje. Kemi dy lloje të demokracisë. Ato janë: demokracia e drejtpërdrejtë dhe demokracia përfaqësuese.

Demokracia e drejtpërdrejtë zhvillohet vetëm në vendet ku ka numër më të vogël të qytetarëve. Qytetarët në mënyrë të drejtpërdrejtë i shprehin mendimet e tyre rreth formimit të ligjeve apo çfarëdo vendimi tjetër në lidhje me shtetin. Kurse demokracia përfaqësuese


është kur populli voton dhe e zgjedh përfaqësuesit e vet. Përfaqësuesit veprojnë në bazë të interesave dhe kërkesave të popullit.

Arsyeja pse demokracia ka kaq shumë rëndësi për ne është për shkak se në demokraci, ne vendosim me anë të votës tonë.

Elementet kryesore të demokracisë janë: bashkëpunimi, toleranca, solidariteti, respekti, paqja, etj.

Në Kosovë kemi besime të ndryshme fetare. Prandaj, ne duhet të tregohemi tolerant dhe t'i respektojmë të gjithë njësoj. Bashkëpunimi gjithashtu si element i demokracisë është i rëndësishëm. Bashkimi i mendimeve të ndryshme të qytetarëve, ndihmon në zgjidhjen e problemeve.

Vota është element tjetër i demokracisë sepse përmes saj, ne ndërtojmë shtetin ashtu siç duam ne. Duhet të votojmë në mënyrë që kërkesat tona të plotësohen.



Njëra nga elementet e demokracisë është toleranca




Fuqia e femrave në demokraci


ROLI I QYTETARËVE NË KOSOVË

ANDI (14), VEBI (15), ARTA H. (14), ARTA S. (14), AGNESA (15), GENTIANA (14), ENIS (14), ELSA (14)

Qytetarët janë ata të cilët vendosin se si do të funksionoj shteti i tyre. E kjo ndodhë duke votuar për personat e duhur të cilët do të na përfaqësojnë neve



Qytetarë jemi të gjithë, pa asnjë dallim




Ajo çka e bënë demokracinë e plotë është qytetaria aktive

Çdo qytetar i Kosovës, duhet të jetë i regjistruar në regjistrin civil dhe duhet të ketë leje qëndrimi për të jetuar këtu. Në qoftë se një qytetar/e i vendit tonë, shkon në Angli, atëherë ai/ajo është vetëm vizitor/e në atë vend. Të jesh qytetar i një shteti demokratik do të thotë të kesh të drejta por njëkohësisht edhe përgjegjësi. Të drejtat tona si qytetarë janë: e drejta e shprehjes së lirë, e drejta e lojës apo argëtimit, e drejta e votës, etj. Për shembull, ta respektojmë ligjet, t'i ndihmojmë prindërit, të mësojmë, t'iu përmbahemi rregullave të komunikacionit, të votojmë, etj. Ne si qytetarë po ashtu duhet të dalim dhe të bëjmë punë vullnetare.

Këtë mund ta bëjmë duke mbledhur mbeturinat, duke mbajtur ambjentin pastër, etj.

Të jesh qytetarë aktiv do të thotë ta ndihmosh shoqërinë ose komunitetin se ku jeton në qfarëdo mënyre që mundemi.

Të dashur lexues, shpresojmë të jeni informuar mjaftueshëm nga artikulli ynë, por nuk do të thotë të që ne të ndalemi me kaq sepse ne demokracinë e praktikojmë çdo ditë. Zbatimi i ligjit nuk është vetëm në të mirën tonë, por në të mirën e të gjithë qytetarëve. Prandaj, prej juve kërkojmë që t'i përbushni përgjegjësitë e juaja, të bëni punë vullnetare dhe t'i praktikoni të gjitha ato që i kemi shkruajtur në këtë artikull.



Vota jonë, bënë ndryshim në shtetin tonë



Qytetarë të Kosovës, me frymë demokratike

TË MIRAT E NDARJES SË PUSHTETIT

BLERON (14), ARGJEND (14), BLERINA (14), ERBLIN (14), FATIME (14), RINA (14), ALTON (14)



A keni menduar ndonjëherë se pse bëhet ndarja e pushtetit në vendet demokratike? Këtë do ta mësoni në artikullin e mëposhtëm


Të jetosh në demokraci do të thotë të jetosh në paqe dhe në harmoni me të tjerët. Në demokraci secili qytetar ka fuqi. Këtë fuqi ata ia besojnë deputetëve. Këta deputetë do t'i përfaqësojnë qytetarët për 4 vjet. Përfaqësuesit tanë punojnë në Kuvend. Institucion ky i cili bën pjesë në njërin prej degëve të pushtetit.

Sigurisht se doni të dini se cilat janë dy institucionet tjera përbërse të ndarjes së pushtetit. Këto dy institucione të tjera janë: Gjykatat dhe Qeveria.

Këto institucione janë të lidhura me njëra-tjetrën dhe janë të pavarura nga njëra-tjetra. Përderisa Kuvendi miraton ligje të reja, Qeveria i vë në zbatim, kurse Gjykatat i mbikëqyr që të dyja, në mënyrë që mos të ketë shkelje të ligjeve.

Qeverinë e udhëheq Kryeministri, kurse Kryeministrin e sjellin në krye të Qeverisë deputetët. E tërë kjo ndarje sigurohet nga sistemi demokratik. Nëse nuk do të ekzistonte kjo ndarje, vendi nuk do të mund të zhvillohej mirë. Kjo për shkak se tërë përgjegjësia do t'i takonte vetëm njëres degë të pushtetit. Kjo ndarje e pushtetit ekziston edhe në Kosovë dhe e mira e saj është se e tërë puna e tri institucioneve bëhet që të ketë zhvillim më të mirë shtetëror.

Qytetarët janë ata të cilët me kontributin e tyre mundësojnë që secili nga këto institucione ta kryej detyrën



Deputeti duke propozuar një projektligj

e vet në mënyrën më të mirë.

Kjo i bie se ligjet që merren nga Kuvendi duhen të zbatohen nga të gjithë qytetarët dhe në momentin kur zbatohen ligjet, shteti ynë funksionon më mirë. Mos harroni se shtetin e ndërtojmë ne me pjesëmarrjen tonë aktive. Andaj, me shumë dashuri iu ftojme edhe juve që të na përkrahni dhe na ndihmoni për ndërtimin e mëtutjeshëm të demokracisë.



Ne jemi qytetarë aktiv

ZGJEDHJET JANË PËR TË GJITHË

LEOTRIM (14), ALBIN (14), FRONTIN (14), ALMEDINË (14), RINESË (14), LABINOT (14), DRILON (14)

Ndryshimi vjen nga zgjedhjet tona. Për të kuptuar më mirë këtë lexojeni artikullin tonë

Çdo njeri ka të drejtën e zgjedhjes pavarësisht se çfarë moshe ka, qoftë nën 18 vjeç ose mbi 18 vjeç. Ne që jemi fëmijë kemi të drejtë të bëjmë zgjedhje personale, duke zgjedhur se çfarë rroba të veshim ose çfarë ushqimi dëshirojmë të hamë.

Në klasën tonë, ne e kemi zgjedhur kryetarin e klasës duke votuar në mënyrë të fshehtë. Mirëpo, kur kemi pasur mundësinë të zgjedhim në mes të dy lëndve, ne kemi votuar në mënyrë të hapur. Këta ishin disa shembuj të situatave kur ne si fëmijë kemi pasur të drejtën e zgjedhjes. Megjithatë, për të votuar në procesin zgjedhorë, ne duhet ti mbushim 18 vjet. Në këtë moshë, do të jemi më të pjekur dhe më të vetëdijshëm për vendimet që i marrim. Me votën të cilën e jep, ti mund ta ndryshosh jetën tënde dhe shumë të tjerëve, prandaj voto edhe ti!




Grupi „Dituria“




Driloni duke e pyetur Albinin për zgjedhjet



Albini duke iu përgjigjur pyetjes së Drilonit



Votimi i mbyllur



Votimi i hapur



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Dëshmorët e 5 Prillit“
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: IX-1
Website: www.demos-ti.org Vendi: Smirë, Viti

Kjo kopje nuk është e redaktuar nga Kuvendi i Kosovës